



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 16.02.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **14.02.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Ardi SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE”** me Nr. të Prok: 206-22-13832-1-1-1 nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Ardi SH.P.K. të dt.14.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE”, me Nr. të Prok: **206-22-13832-1-1-1**, kundër *Njoftimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues (Njoftim për dhënie të Kontratës*, të datës 10.02.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet vendimi i AK për dhënien e kontratës i publikuar me datë: 10.02.2023;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Ardi SH.P.K. me datë 14.02.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE, me Nr. të prokurimit: 206-22-13832-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 16.02.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE Ardi SH.P.K.:**

1. neni 1
2. neni 7
3. neni 66
4. neni 69

### **Pretendimi ankimor**

Autoriteti Kontraktues ne njoftimin per vendim neve si Oe pjesmarres na ka eliminuar per dy arsye sipas komisionit vleresues i cili ka bere vlersimin e ofertes sone, ne si oe pjesmarres ne proceduren e prokurimit publik shpallur nga AK ministria e shendetesise kemi qene shume te pergjegjshem ne oferten tone.

arsyet te cilat na kan eliminuar ne jane diskriminim ndaj nesh dhe shkelje e ligjit te prokurimit publik, me qe rast ky komison vleresues ka shkelur direkt nenin 66 te LPP-se dhe 69 te LPP-se, jemi diskualifikuar per kinse tek kerkesa nr 5 tek pershtatshmeria profesionale eshte kerkuar qertifikate iso 9001 e noterizuar valide dhe pershkak se neve nuk na konfiguron licenca e AKPPM-se ne kete rast tek kerkesa e qertifikates iso 9001 ne e kemi dorezuar origjinale, por edhe po te mos ishte ne rregull ose te mos ekzistone fare ne oferten tone prap AK ishte dashur te kerkonte nje informacion sqarues per arsye se ne jemi OE me qmim me te lire ne disa lloje pra për te ruajtur parane publik AK eshe dashur te kerkoje informata sqaruese ne baze te nenit 69 te LPP-se ndersa tek licenca kur ne kemi dorzuar oferten tone licenca ishte valide dhe kishe afat validiteti ndersa gjate procedures se vleresimit neve na ka skaduar licenca e AKPPM-se dhe ne menjeher kemi bere kerkesen per ripertirje te licences, edhe per kete AK ishte dashur qe per te njejtat arsye te kerkoje informacione sqaruese duke u bazuar ne nenin 66 te LPP-se. kerkojme nga ju qe te rishqyrtoni edhe njeher oferten tone dhe ne te shpallemi fitues ne llotet te cilat kemi dorzuar oferten me te lire.

### **Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore**

Oferta juaj është eliminuar si e papërgjegjshme nga ky aktivitet dy arsye:

1. Për arsye se Certifikatën ISO 9001 qe ju e keni ofruar ne ofertën tuaj nuk ka qene e **Noterizuar** siç është kërkuar ne Dosje te tenderit dhe ne Njoftim për Kontrate (Kërkesa 5 tek përshtatshmeria profesionale - është kërkuar Te dëshmohet me Certifikatë ISO 9001 të ofertuesit- e noterizuar (valide).

Komisioni i vlerësimi ka vepruar konform paragrafit 4 te Nenit 59 te LPP-së , ku specifikohet, citoj:

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Sa i përket Çështjes se Licencës se AKPM-së ju keni ofruar Licencën e AKPPM-se pa ripërtërijë vjetore dhe ne baze te verifikimit ne listën e Depove farmaceutike te licencuara, te publikuar ne faqen zyrtare te AKPPM-se, nuk figuron se jeni te regjistruar, d.m.th. nuk keni licence valide.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

### **Vendimi i dorëzohet:**

1. ARDI SHPK
2. Operatoreve ekonomik te interesuar

  
Berat Marmullaku  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit